

**STATUT**  
**I SHOQERISE "TIRANA ENTRY" shpk**

**DISPOZITA TE PERGJITESHME**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"Tirana Entry"** shpk., eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruar nga ortaket e saj bazuar ne **"Ligjin" Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"**;

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1**

**DATA E THEMELIT, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot, më 23/08/2023 ne Tirane, ne themeluesit si me poshte, bazuar ne Vendim Asambleje Nr. 8, date 22.08.2023 dhe ne vullnetin e lire, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Shoqeria do te emerohet **"Tirana Entry"** shpk.

- Themelues te shoqërisë jane :
  - **Shoqeria "LTD Co" shpk**, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 34 %
  - **Ilir Shtufi**, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 33 %
  - **Kujtim Shtufi**, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 33 %
- Forma e shoqerise eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar

**NENI 2**

**OBJEKTI I SHOQERISE**

Shoqeria ka per objekt kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqipetar.

Me konkretisht por pa u kufizuar ne to, shoqeria **"Tirana Entry"** shpk ka per objekt:

Sherbim hoteleri -turizem. Ofrim Sherbimi si hoteleri, akomodim me qellim pushimi dhe/ose biznesi. Hapje dhe manaxhim i hoteleve, godinave dhe ambjenteve ne te cilat ushtrohet aktivitet hotelerie. Organizim eventesh dhe konferencash. Hapja dhe manaxhimi i sallave te konferencave, asistence dhe sherbim ne mbeshtetje te hotelerise. Hapja, manaxhimi dhe funksionimi i qendrave te rekreacionit, me ose pa profil te dermo-estetikes, trajtimit te lekures

dhe trupit, per masazhe, spa, mirembajtje trupore, fitness dhe pishina. Aktivitet ne fushen e qiradhenies se zyrove, ambjenteve tregtare dhe/ose pasurive te tjera te paluajtshme qe i perkasin hotelit. Kryerja e tregtimit, prodhimit dhe perpunimit te mallrave, qe kane te bejne me aktivitetin e hotelerise; Tregtim (Import – Eksport) të pajisjeve elektrike, elektronike dhe elektroshtëpiake, pajisjeve hidrosanitare, të pijeve alkoolike, dhe jo alkoolike, duhanit e-cigars, mallrave ushqimore, dermoestetike etj. Hapja e manaxhimi i bareve dhe restoranteve brenda struktures hoteliere si edhe ushtrimi i aktivitetit ne fushen e kembimit valutor dhe te mallrave te çmuar, bizhuteri, apo sende me vlere te kuotuar ne burse. Hapja dhe mbajtja e aktiviteteve te lojrave te fatit e kazinove, brenda strukturave hoteliere dhe çdo gje tjeter qe perfshijne fushat e mesiperme, te lejuara nga ligji.

Marrja përsipër e hartimit të projekteve të ndryshme ndërtimore të fushave të ndryshme dhe të realizimit të ndërtimit në përgjithësi; Ndërtim në fushën e turizmit, të infrastrukturës, qendrave të biznesit. Administrim dhe mirëmbajtje të të gjithë elementëve për godinat e ndërtuara, të rikonstruara, sipërfaqeve urbane, rrugëve e shesheve brenda dhe jashtë kompleksve të ndryshëm ndërtimore, administrim dhe mirëmbajtje e të gjithë elementëve për fshatrat turistike, magazinave të ndryshme, depozitave dhe hangarëve, pistave dhe rrugëve dytësore. Aktivitete me destinacion turistik, me ose pa përdorim të ujrave, pyjeve, armëve të zjarrit, atyre të ujit, motorrëve, skafeve, barkave dhe anijeve të përmasave të ndryshme, vendqëndrimeve apo moleve të ndryshëm; Hapja, pjesëmarrja dhe ushtrimi i aktivitetit me anë dhe duke qenë pjesë e shoqërive të tjera dhe atyre off-shore; Realizimi i seminareve trajnuese, kurseve te veçanta per perdorimin e produkteve kozmetike dhe te ngjashme, si dhe trajnimeve te ndryshme ne sherbim te aktivitetit.

Te kryeje cdo aktivitete tjeter qe mud te konsiderohet I dobishem ose I domosdoshem per te arritur qellimin e aktivitetit te saj.

Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licencave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise.

Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj aktiviteti te parasikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes.

### **NENI 3**

#### **ADRESA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete seline e saj ne Hotel Mercure, Tirana ne Godinen “Tirana Entry”, Rr.“29 Nentori”, Tirane.

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

#### **NENI 4**

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar, periudhe e cila mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Ortakeve.

### **KREU II** **KAPITALI**

#### **NENI 5**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 30,000,000 Leke (tridhjetë milion).

Pjesemarrja e themeluesit ne shoqerine eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

Ortaket themelues:

**Shoqeria "LTD Co" shpk**, zoteron 1 kuote me vleren 10,200,000 Leke (dhjete milion e dyqind mije) qe perben 34 % te kapitalit themeltar te shoqerise. Kontributi eshte ne para ose ne natyre, sipas vendimit te ortakeve ne momentin e shlyerjes.

**Irir Shtufi**, zoteron 1 kuote me vleren 9,900,000 Leke (nente milion e nenteqind mije) qe perben 33 % te kapitalit themeltar te shoqerise. Kontributi eshte ne para ose ne natyre, sipas vendimit te ortakeve ne momentin e shlyerjes.


**Kujtim Shtufi**, zoteron 1 kuote me vleren 9,900,000 Leke (nente milion e dyqind mije) qe perben 33 % te kapitalit themeltar te shoqerise. Kontributi eshte ne para ose ne natyre, sipas vendimit te ortakeve ne momentin e shlyerjes.

Ortaket themelues kane rene dakort qe kapitali themeltar do te depozitohet prej tyre, sipas nevojese se shoqerise, me kerkese te administratorit, ne llogarine e saj bankare, pa qene nevoja per nenshkrimin e akteve te tjera per miratimin e ketye depozitimeve, brenda nje afati prej 2 vitesh nga themelimi i kesaj shoqerie. Njekohesisht Ortaket themelues kane rene dakort qe kapitali i shoqerise mund te shlyhet "ne natyre", sipas vendimit te ortakeve.

#### **NENI 6**

#### **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.



Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë, por vete ortaku pranon rivleresimin e pjesës së tij takuese në shoqëri në proporcion me rritjen e kapitalit.

Zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **NENI 7**

#### **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

### **ORGANET VENDIMARRSE, DREJTUESE DHE STRUKTURETE TE SHOQERISE**

#### **NENI 8**


#### **ORGANET VENDIM-MARRESE DHE DREJTUESE TE SHOQERISE**

Shoqëria është e organizuar në organet e mëposhtme:

- 1- Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë
- 2- Administratori
- 3- Menaxheri i përgjithshëm

**Asambleja e Ortakëve** është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme në përputhje me nenin 10 dhe 11 të statutit:



- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarja e fitimit/humbjes vjetore;
  - g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
  - m) njeherazi mund te vendoset mbi lejimin ose marrjen pjese (hyrjen) ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.
- Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates.
- Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **NENI 9**

### **MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 5 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**NENI 10**  
**KUORUMI**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se tre te katertat ose 75% te numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 11**  
**MARRJA E VENDIMEVE**


Asambleja e përgjithshme vendos me 75% ose me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës ceshtjet e meposhteme:

1. për ndryshimin e statutit
2. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
3. shpërndarjen e fitimeve
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, sipas nenit 10 pika 1, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.



- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

### **NENI 13**

#### **ADMINISTRIMI**

- 1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, që fillon me date 23.08.2023 dhe perfundon me date 22.08.2028 me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë për një afat 5 vjeçar nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie pranë QKB-se.
  - **Zj.Fabiola Luli**, atesia Mark, lindur me 19.05.1986 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plote juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Leternjoftim ID me Nr.Personal I65519074I

### **NENI 14**

#### **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori është organi drejtuesi i shoqërisë i cili ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme, të kryejë të gjitha veprimet bankare me cdo bankë të nivelit të dytë, pa asnjë kufizim ;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare, të nënshkruajë kontrata, noteriale ose jo, apo cdo lloj akti tjetër të domosdoshëm që lidhet me aktivitetin e shoqërisë pa kufizim;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

g) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të therrase Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **NENI 15**

### **PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

1.) administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të vecante, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprime të mëposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet e shoqerise;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjendjes financiare duhet të parashikohet që shoqëria nuk kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi;

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **NENI 16**

### **KOMPETENCAT E MENAXHERIT TE PERGJITHSHEM**

Menaxheri i pergjithshem do te jete pozicioni specifik dhe titulli me i larte menaxherial i struktures akomoduese.

Menaxheri ka per detyre dhe do te jete pergjegjes perpara ortakeve per menaxhimin dhe funksionimin e struktures akomoduese.

Menaxheri i pergjithshem do ti paraqese cdo fillim muaji Nentor projekt buxhetin e argumentuar ortakeve. Ai nuk ka te drejt te aplikojte dhe kerkoje shpenzime te tjera pervec sa parashikuar ne buxhetin e miratuar, perjashtim rastet qe pasi verifikohen nga ortakët konsiderohen te domosdoshme.

Te gjitha te drejtat dhe detyrat e tjera do t'i percaktohen ne kontraten qe do te nenshkruaje me administratorin e shoqerise .

**KREU IV**  
**VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

**NENI 17**

**VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**NENI 18**

**EKSPERTET**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

**KREU V**  
**PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**NENI 19**

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 20**

##### **RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **NENI 21**

##### **BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 22**

##### **MOSMARRËVESHJET**

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregtarëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

#### **NENI 23**

##### **TE TJERA**

Autorizohet Z.Enea Mitrushit me numer personal identifikimi I50823030K, për depozitim të këtij Statuti si dhe aplikimin nëpërmjet platformës e-albania për hapjen e Shoqërisë së re "Tirana Entry" shpk, me të drejtën për nënshkrimin elektronik të këtij aplikimi dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm.

#### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**


**"LTD Co" shpk**

Perfaqesuar nga

**Kujtim Shtufi**

KUJTIM SHTUFI  


**Ilir Shtufi**



**Kujtim Shtufi**

KUJTIM SHTUFI  
